# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436579**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Pse më sheh” - Vrasja e 24-vjeçarit në Shkodër, gjykata lë në burg Andri Vulajn! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/pse-me-sheh-vrasja-e-24-vjecarit-ne-shkoder-gjykata-le-ne-burg-andri-vul-i585367` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 10:51:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 11:20:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `80deaf6d6b0bc3d0ffe5d35f9323d8a159cd098af9d1e0b2c5999e489e7cbb89` |
| TEKSTI | `45ea1632dc281bf86dbe9628a020681f6729c83acb85606067949fa628fbb3f1` |
| PAMJA | `1bd6c815123e00e5b8fc1d301f7e193db42a0f3af72130684b98d79456ec0271` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f4a11167181a91215c83c1954e646ccf0dcc09b721165a57dd174f4771e2d4c6` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f4a11167181a91215c83c1954e646ccf0dcc09b721165a57dd174f4771e2d4c6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# “Pse më sheh” - Vrasja e 24-vjeçarit në Shkodër, gjykata lë në burg Andri Vulajn!

11 Shtator 2026, 13:20Kronika TEMA

“Pse më sheh” - Vrasja e 24-vjeçarit në

Gjykata e Shkodrës ka vendosur masën ‘arrest në burg’ për Andri Vulaj, autor i vrasjes të Ylber Lulit më 8 shtator në lagjen “Kongresi i Përmetit”.

25-vjeçari nuk ka dhënë asnjë dëshmi as në gjykatë dhe as në polici. E vetmja dëshmi është ajo e avokatit mbrojtës, Arbër Raja i cili deklaroi se autori i dyshuar ka dëmtime me thikë në fytyrë, qafë dhe pjesën e krahut në njërën dorë.

Pala mbrojtëse i kërkoi prokurorisë që të vlerësojë këto dëmtime që ka autori i dyshuar se përse kanë ardhur dhe nga kanë ardhur.

Ndërkohë babai i viktimës Qamil Luli ka deklaruar në dëshminë e tij se ka qenë në gjumë dhe ka dëgjuar zhurma nga sherri mes djalit të tij dhe autorit të dyshuar.

Pasi ka dalë në oborr, babai ka pranuar se kanë goditur me thikë autorin e dyshuar dhe më pas është qëlluar djali i tij Ylber Luli i cili ka marrë një plagë në pjesën e barkut duke humbur jetën.

Po ashtu prokuroria ka cituar gjatë masës së sigurisë se autori i dyshuar ka shkuar me dy persona që viktima i ka njohur dhe e kanë shoqëruar deri tek banesa.

Sipas organit të akuzës, viktima Ylber Luli përmes SMS i ka kërkuar dy shokëve të tij që ta sjellin në shtëpi autorin Andri Vulaj që të sqaroheshin.

Pasi kanë shkuar tek shtëpia ka ndodhur konflikti mes dy të rinjve, të cilët fillimisht janë përleshur dhe pas plagosjes me thikë të Andri Vulaj, dyshohet se ky i fundit ka qëlluar me një pistoletë të vogël, me forcë tejshpuese nga afërsia duke lënë të vdekur Ylber Lulin.

Prokurorja Albulena Kuliçi kërkoi masën e sigurisë “arrest me burg”, kërkesë të cilën gjyqtarja Zamira Lila e pranoi duke lënë në paraburgim autorin e dyshuar të dyshuar të vrasjes Andri Vulaj.

Sherri mes tyre deri më tani pretendohet se ka ndodhur në një lokal në pedonalen e Shkodrës mes dy të rinjve, të cilët kanë debatuar duke i thënë njëri-tjetrit “pse më sheh”.

Ky konflikt u zhvendos në banesën e viktimës duke përfunduar në mënyrë tragjike me vdekjen e Ylber Lulit i cili u qëlluar me armë zjarri.

Pala mbrojtëse është duke pritur të njihet me aktet dhe provat që ka prokuroria. Më pas autori i dyshuar mund të dëshmojë për ngjarjen e rëndë ndërsa për momentin sipas burimeve, ai është në gjendje të rëndë psikologjike.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

Emri *

POSTOJE KOMENTIN

Po trafikonte 11 klandestinë nga Pakistani dhe Bangladeshi drejt vendeve të BE, arrestohet 27-vjeçarit në Korçë

11:50 Kronika

Luan Baçi në SPAK, deputeti demokrat paraqitet së bashku me avokatin

11:09 Kronika / 3 komente

Merr drejtimin e Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo: Përgjegjësi e madhe, do të çojmë përpara prioritetet e qeverisë

11:00 Kronika / 1 koment

PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?

10:40 Kronika / 23 komente

"Kallëzimi në SPAK është idiot", Manjani: Ligji e ndalon, por gjyqtarët dhe prokurorët po bëjnë grevë…

23:15 Kronika / 12 komente

U kap me armë zjarri dhe jelek antiplumb, arrestohet pronari i një hoteli në Fushë-Krujë

23:05 Kronika / 1 koment

Trafik armësh? Drejtuesi i KAYO mohon akuzat: Nuk jemi përfshirë! (Çfarë thotë për Ron Yeffet?)

22:25 Kronika / 6 komente

Patos-Marinzë/ Banorët kërkojnë zgjidhje përfundimtare nga Bankers për qiratë e tokave, ngujohen në zyrat e kompanisë

22:05 Kronika / 2 komente

Zjarret në vend/ 30 vatra gjatë ditës, 7 mbeten aktive! Mbi 400 forca në terren

21:45 Kronika

Kontroll në burgun e Shkodrës, kapet i dënuari me drogë dhe celular

21:15 Kronika / 1 koment

**Më të lexuarat**

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 20 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 29 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” m...**

15:30 Dossier / 12 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 20 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.